



NIS AFATI 34 DITËSH PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT

FAQE 4-5



Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë mbi një muaj kohë për ta zgjedhur presidentin e ri, pasi gjykata më e lartë në vend ka rrezuar një ditë më parë

dekretin e presidentes së tanishme, Vjosa Osmani, për shpërndarjen e Kuvendit pas moszgjidhjes së presidentit në një seancë më 5 mars. Nëse

brenda afatit 34 ditësh deputetët nuk arrijnë ta zgjedhin presidentin e ri, Kuvendi shpërndahet dhe vendi shkon në zgjedhje të reja parlamentare



HASANI: VENDIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE ËSHTË PROFESIONAL, NDËRSA DEKRETI I OSMANIT KA QENË TËRËSISHT KUNDËRKUSHTETUES

F. 3



NËSE KURTI E KA PËRNJËMEND, E KA VETËM NJË MUNDËSI REALE PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT

F. 5

Shkruan: Hajdin ABAZI

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

PRESIDENTI KURTHI! F. 7

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



GRANIT PLAVA NDËRRON DEKLARATËN PËR VRASJEN E LIRIDONA ADEMAJT, THOTË SE KISHTE MARRËVESHJE ME NAIM MURSELIN

F. 7

EKONOMI



GAP-i: KOSOVA MBI MESATAREN NË TRANSPARENCË BUXHETORE, POR ME MANGËSI NË MBIKËQYRJE

F. 8

ABDIXHIKU PËR NJEHSORËT ELEKTRIKË: KUR SHTETI DËSHTON, PADREJTËSIA HYN NË ÇDO SHTËPI

F. 8

SPORT



OSMANI VIZITON QENDRËN NACIONALE TË XHUDOS NË PEJË

F. 11

ÇFARË PËRMBAJNË PLANET PËR PAQE ME IRANIN?

TEHRAN, 26 MARS - Plani i Uashingtonit për t'i dhënë fund luftës me Iranin përmban 15 pika, ndërsa ai i Teheranit vetëm pesë, por secili prej tyre shkel vijat e kuqe të palës tjetër. Hollësitë e planit amerikan nuk janë bërë me dije, por është raportuar bujshëm për to. Besohet se ai është i ngjashëm në shumë mënyra me propozimet e bëra para se të fillonte lufta e tanishme kur Izraeli dhe ShBA-ja nisën bombardimet më 28 shkurt. Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt, u ka thënë gazetarëve se “ka elemente të së vërtetës” në raportimet e medieve për 15 pikat. Në planet konkurruese, elementet e reja mendohet se përfshijnë kërkesa nga të dyja palët lidhur me Ngushticën e Hormuzit, një rrugë jetike për furnizimet globale me naftë, gaz dhe mallra të tjera, të cilën Irani tani po e mban të bllokuar.

Kërkesat e ShBA-së

Kërkesa më e rëndësishme e ShBA-së është ajo që presidenti amerikan Donald Trump e ka theksuar vazhdimisht. Ai thotë se Irani është pajtuar me të. “Ata duan të bëjnë marrëveshje”, u tha ai gazetarëve në Zyrën Ovale më 24 mars. “Ata janë pajtuar se nuk do të zotërojnë kurrë ndonjë armë bërthamore”. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre, përfshirë Izraelin dhe vendet kryesore evropiane, për shumë vjet kanë shprehur shqetësim për mundësinë që Irani të zhvillojë armë bërthamore. Por, Irani gjithmonë e ka mohuar se dëshiron ta bëjë këtë. Edhe sikur kjo do të ishte e vërtetë, Irani tani ka udhëheqje të re dhe ka qenë shënjestër e sulmeve të mëdha nga ShBA-ja dhe Izraeli, që nisën dy luftëra: e para në qershor të vitit të kaluar. Synimet e udhëheqësit suprem Mojtaba Khamenei, i cili ende nuk është parë qëkurse u emërua më 8 mars, mbeten të paqarta. Po ashtu, nuk është plotësisht e qartë se deri në çfarë mase ai apo aktorë të tjerë po marrin vendime në Teheran, apo në çfarë mase zyrtarët e lartë iranianë janë në gjendje të komunikojnë mes vete në mes të bombardimeve të vazhdueshme që kanë vlarë shumë figura të larta. Trumpi tha më 25 mars se zyrtarët iranianë kanë “frikë” ta pranojnë se po bisedojnë me amerikanët, “sepse mendojnë se do të vriten nga njerëzit e vet”.



Plani me 15 pika besohet se përfshin një armëpushim njëmuor derisa të përpunohen hollësitë. Ai përfshin shumë kërkesa të tjera amerikane, si çmontimi i objekteve bërthamore iraniane, dorëzimi i rezervave të uranimit të pasuruar tek Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (IAEA) dhe pajtimi për të mos pasuruar uranium në të ardhmen. Pika të tjera thuhet se vendosin kufizime mbi kapacitetet raketore të Iranit dhe ndalimin e mbështetjes së tij për forcat rajonale, si Hezbollahu, grupi libanez i shpallur organizatë terroriste nga Uashingtoni. Derisa shumë nga këto ishin kërkesa amerikane edhe para luftës, disa, si rihapja e Ngushticës së Hormuzit dhe ndalimi i sulmeve iraniane ndaj objekteve energjetike rajonale, do të ishin përgjigje ndaj veprimeve të Iranit gjatë luftës që nga 28 shkurti.

Në këmbim Irani do të përfitonte heqjen e sanksioneve dhe ndihmë nga ShBA-ja për një program civil të energjisë bërthamore. “Parametrave të propozimit amerikan nuk u mungon ambicia: lehtësim sanksionesh në këmbim të lëshimeve të mëdha nga Irani”, tha për Radion Evropa e Lirë, Naysan Rafati, analist për Iranin në Grupin Ndërkombëtar të Krizave. “Por, nëse e kaluara është tregues, realizueshmëria e tij do të varej nga gatishmëria e republikës islamike për t’iu nënshtruar trysnisë në çështje që kanë qenë prej kohësh vijat e saj të kuqe. Në frontin bërthamor, për shembull, Teherani ka vazhduar të

këmbëngulë në të drejtën për pasurimin e uranimit... Ai gjithashtu e ka hedhur poshtë mundësinë e bisedimeve për programin e tij raketor”, shtoi ai.

Qëndrimi i Iranit

Zyrtarët iranianë jo vetëm që kanë thënë se bisedimet nuk po zhvillohen, por edhe janë tallur me deklaratat e amerikanëve për këtë çështje si, për shembull, kur zëdhënësi ushtarak Ebrahim Zolfaqari tha se administrata Trump po “negocion me veten”. “Asnjëri sikur ne nuk do të bëjë marrëveshje me ju. As tani. As kurrë”, theksoi ai më 25 mars. Ndërkohë, disa nga kërkesat e Teheranit bien ndesh me qëndrimet amerikane. Ndër to janë njohja e kontrollit ose autoritetit të Iranit mbi Ngushticën e Hormuzit, së bashku me të drejtën për të vendosur tarifa kalimi, dhe të drejtën për një program të pakufizuar raketor. Kërkesat e Iranit gjithashtu shkelin qartë vijat e kuqe të ShBA-së, sepse duan që Uashingtoni t’i mbyllë bazat e tij ushtarake në Gjirin Persik, të paguajë dëmshpërblime lufte dhe të garantojë se nuk do ta sulmojë më Iranin. “Tani, të paktën, premtimi për lehtësim ekonomik dhe dhimbja nga sulmet e vazhdueshme duket se nuk do ta nxisin Iranin për të bërë ndonjë lëshim në shkallën që kërkon Uashingtoni”, tha Rafati. “Regjimi në tërësi ende nuk e sheh pozicionin e tij në luftë si mjaftueshëm të dëshpëruar për t’i pranuar kushtet e ShBA-së”.

Fred Fleitz, nënkryetar i Qendrës për Sigurinë Amerikane në America First Policy Institute, ka një vlerësim të ngjashëm. “Mendoj se sfida më e madhe është ta bindim regjimin iranian të pajtohet për diçka. Ne jemi ende në pikën ku duhet t’i bëjmë ata të pranojnë të ulen për bisedime. Mendoj se kemi bërë disa përparime me disa kërkesa fillestare, por duhet të kemi një përfaqësues iranian që ulet me ShBA-në ose me një ndërmjetës për t’i filluar bisedimet”, i tha ai Radios Evropa e Lirë.

Mohammad Baqer Qalibaf, njeriu me të cilin ShBA-ja mund të jetë duke komunikuar në Iran

Raportimet e kësaj jave sugjerojnë se administrata e presidentit amerikan Donald Trump po e shqyrton në heshtje kryetarin konservator të Parlamentit iranian, Mohammad Baqer Qalibaf, si partner i mundshëm për negociata, e ndoshta edhe si lider i ardhshëm të Iranit. Uashingtoni ishte në kërkim të një kanali komunikimi për bisedime që prej vdekjes së udhëheqësit suprem Ali Khamenei, në ditën e parë të sulmeve ajrore amerikane-izraelite kundër Iranit. Djali i Khameneit është përmendur si pasardhës, por ai nuk është parë në publik që nga

dita e vdekjes së të atit dhe raportohet se ka mbetur i plagosur në sulm. Në këtë kontekst qarkullojnë edhe spekulime për Qalibafin si figurë që disa në Shtëpinë e Bardhë e shohin si partner i pranueshëm për negociata.

Vetë Qalibafi, 64 vjeç, i ka mohuar kategorikisht këto pretendime, duke shkruar në platformën X se “nuk ka pasur asnjë negociatë me ShBA-në”, ndërsa raportimet i ka cilësuar “lajme të rreme”, të dizajnuara për t’i manipuluar tregjet financiare dhe ato të naftës.

Pavarësisht nëse ekzistojnë ose jo kontakte të fshehta, shfaqja e tij si figura më e dukshme e nivelit të lartë në një sistem që po përjeton shpërbërje strukturore në vendimmarrje, e ka bërë - për herë të parë gjatë një karriere të mbushur me mundësi të humbura - njeri me peshë reale në skenën politike.

Qalibaf është një politikan konservator dhe ish-komandant ushtarak, i cili për dekada të tëra ka ndërtuar lidhje të forta me udhëheqjen më të lartë të Iranit dhe me Korpusin e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC). Megjithatë, pas një karriere të shoqëruar nga skandale korrupsioni dhe kandidime të pasuksesshme për presidencën, ai e gjen veten - në mënyrë paradoksale - si figura ndoshta më e fuqishme që ka mbetur në Republikën Islamike.

I lindur në vitin 1961, Qalibaf iu bashkua IRGC-së në moshën 18-vjeçare dhe u ngjit në hierarki gjatë luftës Iran - Irak të viteve 1980-1988, duke u bërë komandant njësie. Më vonë ai shërbeu komandant i Forcave Ajrore të IRGC-së - para se ato të riemërtoheshin si Forca Hapësinore-Ajrore - një post që iu besua drejtpërdrejt nga udhëheqësi i atëhershëm suprem, Ali Khamenei, dhe një shprehje besimi që do ta përcaktonte trajektoren e tij politike për tri dekadat në vijim.



HASANI: VENDIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE ËSHTË PROFESIONAL, NDËRSA DEKRETI I OSMANIT KA QENË TËRËSISHT KUNDËRKUSHTETUES

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, e vlerëson si profesional aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me rrëzimin e dekretit të presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit si dhe afatin 34 ditor shtesë për zgjedhjen e presidentit të ri. Profesori i së drejtës ndërkombëtare, në një intervistë për “KosovaPress”, thekson se ndonëse arsyetimi juridik i vendimit është korrekt, gjuha e përdorur në dispozitiv “reflekton njëfarë hezitimi” të Gjykatës për ta emërtuar drejtpërdrejt situatën si vendim kundërkushtetues të Osmanit, siç thotë për shkak të frikës dhe presionit që i është bërë këtij institucioni



PRISHTINË, 26 MARS -

Si e vlerësoni vendimin e Gjykatës Kushtetuese për t'i dhënë Kuvendit edhe 34 ditë shtesë për zgjedhjen e presidentit? A është ky interpretim në përputhje të plotë me frymën e Kushtetutës?

Hasani: Aktgjykimi është profesional në pjesën arsyetuese, por në dispozitiv ka një gjuhë që, në tërësi, ngjason me dispozitivin e aktgjykimit të parë të vitit të kaluar për konstituimin e Kuvendit. Kjo gjuhë është e qartë për juristët kushtetues, por reflekton njëfarë hezitimi të Gjykatës Kushtetuese për ta emërtuar drejtpërdrejt fenomenin e përshkruar. Nuk i fajësoj aspak, duke marrë parasysh faktin që kanë qenë nën presion vitin e kaluar, aq sa një pjesë e gjyqtarëve kanë qenë edhe të ekspozuar ndaj rrezikut fizik.

A përbën kjo një praktikë të kushtetuese apo është brenda kornizës së interpretimit të mëhershëm të Gjykatës?

Hasani: Po. Arsyetimi është korrekt dhe tregon qartë se, në një

sistem parlamentar, shefi i shtetit (presidenti apo monarku) nuk mund ta shpërndajë parlamentin në mënyrë autonome dhe jashtë autorizimit të shprehur kushtetues. Për këtë arsye, në dispozitiv, Gjykata ka theksuar se dekreti i presidentes së Republikës për shpërndarjen e Kuvendit nuk ka prodhuar asnjë efekt juridik. Kur një akt juridik nuk prodhon asnjë efekt juridik, atëherë kemi të bëjmë me pavlefshmëri absolute të aktit. Ky është një emërtim tjetër për të thënë se dekreti ka qenë tërësisht kundërkushtetues. Këtë nuk e ka thënë Gjykata për shkak të frikës dhe presionit që ka pasur vitin e kaluar dhe në raste të tjera.

Gjykata ka konstatuar se dekreti i presidentes për shpërndarjen e Kuvendit nuk prodhon efekt juridik. Sa i qëndrueshëm është ky arsyetim në aspektin praktik?

Hasani: Siç e thashë, bëhet fjalë për përshkrimin e një akti juridik si tërësisht kundërkushtetues, meqë nuk ka prodhuar asnjë pasojë juridike. Pra, dekreti për

shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës është tërësisht i pavlefshëm, sikur të mos kishte ekzistuar fare. Kjo është shkalla më e lartë e kundërkushtetutshmërisë dhe përfshin nenet e Kushtetutës të përmendura në paragrafin 4 të aktgjykimit që flet për objektin e çështjes.

A ka pasur hapësirë kushtetuese që presidentja të veprojë ndryshe në këtë situatë? Çfarë pasojash juridike dhe kushtetuese mund t'i ketë ajo pas këtij vendimi jokushtetues?

Hasani: Sigurisht që presidentja e Republikës ka gabuar kur ka shpërndarë kuvendin, meqë ka shpërndarë përfaqësuesin e sovranit. Këtë të drejtë nuk e ka askund presidenti i republikës në një sistem parlamentar, dhe këtë e ka thënë qartë Gjykata në pjesën arsyetuese, kur ka dhënë zgjidhjet krahasimore kushtetuese. Njëjtë si në Kosovë, në asnjë kushtetutë të Evropës që ka sistem parlamentar, shefi i shtetit nuk ka kompetencë

autonome për shpërndarjen e parlamentit. Asnjë pasojë nuk mund të ketë për zonjën Osmani, sepse objekti i çështjes nuk ka qenë vlerësimi nëse presidenti i Republikës ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por nëse dekreti i presidentit të Republikës së Kosovës për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës, në vetvete, është kushtetues. Ky, në fakt, është vetë titulli i aktgjykimit të sotëm:

“Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit [nr. 24/2026] të 6 marsit 2026 të Presidentes së Republikës së Kosovës”. Nëse dikush mendon se zonja Osmani ka shkelur Kushtetutën e Kosovës, mund të nisë procedurat para Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 9.2, në lidhje me nenin 113.6 të Kushtetutës së Kosovës. Në një procedurë të tillë, aktgjykimi i sotëm shërben si fakt dhe pala iniciuese duhet të arsyetojë saktë pse dhe si zonja Osmani ka shkelur Kushtetutën e Kosovës. Pra, thënë me fjalë të tjera, pala që nis një procedurë të tillë - 40

deputetë të Kuvendit të Kosovës - duhet të argumentojnë shkeljet kushtetuese që kanë qenë objekt shqyrtimi të aktgjykimit të sotëm. Afati për vendosje për atë nëse presidentja Osmani ka shkelur Kushtetutën është shtatëditor dhe nuk ka lidhje nëse ajo e përfundon mandatin. Sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe praktikës standarde në gjyqësinë kushtetuese evropiane, gjykatat kanë të drejtë të vazhdojnë procedurën edhe atëherë kur bie objekti i shqyrtimit, për çfarëdo arsye qoftë. Shkarkimi i presidentit të Republikës, sipas nenit 91.3 të Kushtetutës, është një çështje krejt tjetër. Me fjalë të tjera, procedura për vlerësimin nëse presidentja Osmani ka shkelur Kushtetutën e Kosovës është e ndarë nga përfundimi i funksionit të saj, sepse shkarkimi, edhe në rast të një presidenti aktiv, mund të mos ndodhë në Kuvendin e Kosovës, meqë kërkohet shumica prej dy të tretash të deputetëve. Nëse kjo procedurë do të niset, mbetet në vlerësimin e aktorëve politikë.

Shënohet përvjetori i 27 i masakrës në Celinë

RAHOVEC, 26 MARS - Në 27-vjetorin e rënies janë përkujtuar të enjten 75 martirët e fshatit Celinë, të rënë më 25 mars të vitit 1999. Në tubimin përkujtimor i pranishëm ka qenë edhe kryetari i komunës

së Rahovecit, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë, përfaqësues të institucioneve qendrore, deputetë, përfaqësues të OVL-së, familjarë të të rënëve dhe qytetarë të këtyre fshatrave dhe fshatrave përreth. “Me respekt

dhe përvjetorin e 27 i masakrës në Celinë, me bashkëpunëtorë, përfaqësues të institucioneve qendrore, deputetë, përfaqësues të OVL-së, familjarë të të rënëve dhe qytetarë të këtyre fshatrave dhe fshatrave përreth. “Me respekt





NIS AFATI 34 DITËSH PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë mbi një muaj kohë për ta zgjedhur presidentin e ri, pasi gjykata më e lartë në vend ka rrëzuar një ditë më parë dekretin e presidentes së tanishme, Vjosa Osmani, për shpërndarjen e Kuvendit pas moszgjidhjes së presidentit në një seancë më 5 mars. Nëse brenda afatit 34 ditësh deputetët nuk arrijnë ta zgjedhin presidentin e ri, Kuvendi shpërndahet dhe vendi shkon në zgjedhje të reja parlamentare

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 MARS - Ligjvënësit në Kosovë kanë mbi një muaj kohë për ta zgjedhur presidentin e ri të vendit, pasi gjykata më e lartë në vend ka rrëzuar një ditë më parë dekretin e presidentes së tanishme, Vjosa Osmani, për shpërndarjen e Kuvendit pas moszgjidhjes së presidentit në një seancë më 5 mars.

Dekreti, sipas Gjykatës Kushtetuese, nuk ka efekt juridik. Nga Presidenca e Kosovës e mirëprirën vendimin dhe thanë se është konstatuar se Osmani nuk ka bërë shkelje kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese e publikoi aktgjykimin e plotë lidhur me dekretin e Osmanit të nxjerrë më 6 mars, duke vendosur se në rast

se brenda 34 ditësh, nga sot kur ka hyrë në fuqi aktgjykimi, deputetët nuk zgjedhin presidentin, Kuvendi shpërndahet.

Sipas vendimit, pas shpërndarjes 'ex constitutione' (shpërndahet në mënyrë automatike në bazë të Kushtetutës) së organit ligjvënës, Kosova duhet të mbajë zgjedhje të reja brenda 45 ditësh. Në aktgjykimin e saj, Kushtetuesja tha se Kuvendi i Kosovës shpërndahet në tri raste: nëse brenda 60 ditësh nga data e caktimit të mandatarit nga presidenti nuk formohet qeveria, nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë 2/3 e të gjithë deputetëve dhe nëse brenda 60 ditësh nga data e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjidhet presidenti i Kosovës.

"Gjykata marrë për bazë kontekstin specifik të rrethanave të konstituimit të Kuvendit më 11 shkurt 2026, vlerësoi se Kuvendi nuk ka pasur gjashtëdhjetë 60 ditë në dispozicion, brenda së cilës periudhë duhej përfunduar procedura për zgjedhjen e presidentit", u tha në vendim të Kushtetueses.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, procedura për zgjedhjen e presidentit, "që nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë", duhet të përfundojë "jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentit aktual". "Këto dy afate janë të ndërlidhura, në atë mënyrë që procedura duhet të zhvillohet brenda kufirit prej 60 ditësh dhe të përfundojë me zgjedhjen e presidentit jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentit aktual", u tha në vendim.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese vjen pasi në fillim të këtij muaji Kushtetuesja e kishte pezulluar përkohësisht deri më 31 mars dekretin e presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit. Ajo ia kishte ndaluar çdo veprim presidentes Osmani në lidhje me dekretin e 6 marsit si dhe punën e Kuvendit deri në përfundim të pezullimit.

Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dekretit për shpërndarjen e Kuvendit ishte dorëzuar nga kryeministri Albin Kurti në emër të qeverisë.

Presidenca: Kushtetuesja nuk ka konstatuar shkelje të presidentes Osmani

Disa orë pas publikimit të aktgjykimin, Presidenca e Kosovës tha se e mirëpret atë, duke argumentuar se organi më i lartë juridik në vend nuk gjeti asnjë shkelje kushtetuese të presidentes Osmani. "Në përputhje me komentet e dërguara nga Presidenca, edhe vetë Gjykata Kushtetuese e konfirmon se afati 60-ditor duhet të konsumohet para afatit 30-ditor të paraparë në nenin 86.2 të Kushtetutës, dhe se ky afat 30-ditor para përfundimit të mandatit të presidentit aktual është përfundimtar dhe detyrues, si dhe nuk mund të relativizohet", thuhet në reagim. Ky institucion reagoi edhe ndaj deklaratave politike se Osmani ka shkelur Kushtetutën, duke thënë se këto tregojnë një keqlexim të aktgjykimin dhe "politizim të skajshëm të një situate tashmë të qartësuar nga

Gjykata Kushtetuese: që dështimi për zgjedhjen e presidentit të vendit është i deputetëve dhe si pasojë e mungesës së vullnetit politik për të arritur konsensus rreth zgjedhjes së presidentit".

Presidenca tha se Kushtetuesja konfirmoi se vendi nuk shkon në zgjedhje të reja përmes një dekreti, "është dështimi i Kuvendit për zgjedhjen e presidentit të ri ai që i shkakton këtë proces të zgjedhjeve".

Në reagim u tha se në komentet dërguar Kushtetueses, Osmani kishte shprehur po këtë qëndrim. "Rrjedhimisht, duke qenë se rrethana e moskonstituimit të Kuvendit me kohë nuk ka qenë e paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Gjykata ka interpretuar një rrethanë përjashtuese që vlen për këtë rast specifik, duke sqaruar se 'në të gjitha rastet e zgjedhjes së presidentit në të ardhmen, përkatësisht procedura për zgjedhjen e presidentit të ri, e cila nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë, duhet të fillojë përpara dhe të përfundojë jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentit aktual'", u tha në reagim.

Osmani u tha se e mirëpret afatin 34-ditor dhe u bënë thirrje

NËSE KURTI E KA PËR NJËMEND, E KA VETËM NJË MUNDËSI REALE PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT



Shkruan: Hajdin ABAZI

Kushtetuesja, më në fund, e tha fjalën e vet: 34 ditë afat për zgjedhjen e presidentit, ose zgjedhje parlamentare. Partia në pushtet përmes kryeparlamentares doli me prononcime se “do të bëjmë çmos” që të arrihet zgjidhja e jo zgjedhjet. Dy janë mundësitë për të evituar zgjedhjet e reja. Njëra është LVV (57) + LDK (15) + minoritetet (11), që arrihet numri prej 83 deputetësh. Mundësia tjetër është LVV (57) + PDK (22) + minoritetet (11), që arrihet numri prej 90

deputetësh. Mundësia e parë duket pak e gjasshme, pasi që tashmë po dihet se V. Osmani po filtron me LDK për rikthimin e saj aty. Marrëveshja mund të bëhet nëse Kurti e pranon V. Osmanin për rikandidim për presidente, gjë që duket e pabesueshme, e kjo e bën të pagjasshme një marrëveshje LVV dhe LDK. Aq më tepër që LDK me rikthimin e V. Osmanit llogarit ta rikthejë një pjesë të elektoratit e kështu ta shtojë numrin e deputetëve, ndaj ajo duket e prirë për zgjedhje. AAK, me gjithë konstruktivitetin

politik për konsensus, e vetme nuk mundet të jetë ajo që ofron zgjidhje për zgjedhjen e presidentit. Mbetet mundësia e dytë. PDK realisht mundet të ofrojë daljen nga kriza. PDK + LVV + minoritetet mund ta zgjedhin presidentin dhe do të shmangeshin zgjedhjet. Se a do të bëhet kjo apo jo varet para së gjithash prej LVV, në kuptimin se a e ka me gjithë mend mos shkuarjen në zgjedhje të reja nacionale apo jo. Nëse e ka, duhet të jetë e gatshme për kompromis. Nëse nuk e ka, e

luan lojën e imponimit, dhe nuk gjendet gjuha e përbashkët. Por po ashtu varet edhe nga PDK, në kuptimin se PDK a synon postin e presidentit apo ndarjen e pushtetit ekzekutiv. Këtu do të jetë fusha e manovrare për negociata. Në interes të PDK mund të jenë postet ministrore, por ne interes të shtetit është posti i presidentit. Për mendimin tim, PDK duhet të prioritojë te presidenti. Kësisoj rikthehet praktika e mirë e kultivuar në Kosovën e pas luftës çlirimtare që një parti e vetme të mos i ketë kryeministrin,

kryeparlamentarin dhe presidentin. Me këtë do të mbrohej sado pak demokracia. Nuk duhet të refuzohet apriori kompromisi nga partite opozitare, edhe se kjo nuk është kulturë demokratike, po edhe për mos t’ia krijuar LVV adutin e bllokadës nga opozita. Opozita duhet të tregojë se nuk është për bllokadë, por për zgjidhje. Dhe zgjidhja duhet të vijë nga Kurti dhe LVV përmes ndarjes së pushtetit me partinë që i ofron zgjedhjen e presidentit, natyrisht të një të pranueshëm edhe nga LVV.

deputetëve që “urgjentisht” ta kryejnë detyrimin kushtetues për zgjedhjen e pasardhësit të saj, duke i ftuar që qysh nesër të caktojnë një seancë për zgjedhjen e presidentit.

LV: Gjykata konfirmoi se dekreti i Osmanit ishte në kundërshtim me Kushtetutën

Pas publikimit të vendimit, shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, tha se Gjykata konfirmoi se dekreti i presidentes Osmani për shpërndarjen e Kuvendit ishte në kundërshtim me Kushtetutën. “Veprimet në pozitat institucionale duhet të kryhen me përgjegjësi të lartë dhe pa inate personale. Ky moment duhet të shërbejë për reflektim dhe për angazhim të të zgjedhurve të popullit, në mënyrë që vendi të mos futet në një krizë të re dhe në një cikël të përsëritur zgjedhjesh”, shkroi Nagavci në “Facebook”. Sipas saj, në ditët në vijim LV-ja do të angazhohet për zgjedhjen e presidentit të ri dhe të

shmangen zgjedhjet e reja, që i cilësoi “të panevojshme dhe të padrejta”.

Abdixhiku: LV-ja ka detyrë të ofrojë zgjidhje, ne jemi të gatshëm të kontribuojmë

Kreu i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, tha se vendimi ka sjellë qartësi të nevojshme “në një moment të rëndësishëm institucional” për Kosovën, duke shtuar se subjekti që ai udhëheq e respekton plotësisht vendimin. Sipas tij, vendimi nuk krijon epërsi për askënd. Por, ritheksoi se përgjegjësia kryesore mbetet te shumica parlamentare. “Ajo ka pasur kohën dhe mundësinë për ta përmbyllur këtë proces dhe është detyrë e saj të ofrojë zgjidhje. Siç tashmë është e qartë, pa votat e shumicës, ky proces nuk mund të përmbyllet”, shkroi Abdixhiku në “Facebook”. Sipas tij, çështjet e tilla zgjidhen me marrëveshje politike e jo “me imponim”. “Në këtë frymë, LDK mbetet e gatshme të kontribuojë në çdo përpjekje serioze për zgjidhje, që garanton stabilitet

dhe funksionim normal të institucioneve. Por, njëkohësisht, nuk do të bëhet alibi e dështimeve të askujt”, tha ai. Abdixhiku, megjithatë, tha se dekreti i Osmanit dhe veprimet e saj për këtë çështje, “kanë qenë në funksion të ruajtjes së rendit kushtetues dhe të shmangies së një vakumi institucional, në një situatë të paqartë juridike”. “Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, përveçse nuk konstaton ndonjë shkelje kushtetuese, ofron interpretimin përfundimtar rreth kësaj çështjeje, i cili duhet të respektohet nga të gjithë”, tha ai. Vendimi i gjykatës më të lartë në vend nxitu reagime edhe nga njohës të zhvillimeve politike dhe juridike. Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi shkroi në “Facebook” se vendimi nxori në pah se nuk ka normë kushtetuese e as praktikë gjyqësore që detyron deputetët të qëndrojnë në sallë gjatë zgjedhjes së presidentit. Ndërkaq njohësi i zhvillimeve politike, Ilir Deda, shkroi se Kushtetuta sqaroi “njëherë e

përgjithmonë” çështjen e zgjedhjes së presidentit. “Shkurt e shqip, nëse nuk mund të merreni vesh - pa imponim, shkohet në zgjedhje”, tha ai. Në seancën e 5 marsit partia në pushtet i paraqiti dy kandidatë për president: Glauk Konjufcën dhe Fatmire Kollçaku-Mullhaxhën, pasi bisedimet paraprake mes Kurtit dhe dy partive kryesore opozitare, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, për një emër të pranueshëm, nuk kishin dhënë fryt. Seanca u ndërprerë në mungesë kuorumi, pasi ishte braktisur nga partitë opozitare. Një ditë pas ndërprerjes së seancës më 5 mars, Osmani nxori dekretin për shpërndarjen e Kuvendit dhe e mbajti menjëherë një takim me partitë politike për të folur për datën e zgjedhjeve të parakohshme. Në takim morën pjesë kryetarë të partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, por jo edhe partia e kryeministrit Kurti. Osmani e arsyetoi dekretin e saj,

duke thënë se 5 marsi ishte afati i fundit për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës, meqë mandati i saj përfundon më 4 prill, por që deputetët kishin dështuar t’i përmbushnin afatet ligjore. Por, partia në pushtet nguli këmbë se dekreti i Osmanit nuk kishte bazë, meqë procedurat për zgjedhjen e presidentit i kishte nisur më 5 mars dhe se kishte afat prej 60 ditësh për ta përfunduar procesin, prandaj edhe u ankua në Kushtetuese. Presidenti i Kosovës zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para apo me 61 vota në raundin e tretë, por nevojiten 80 deputetë në sallë që seanca të mund të mbahet. Për partitë opozitare dy emrat e paraqitur nga partia në pushtet ishin të papranueshëm dhe ato këmbëngulën në marrëveshje politike ose të paraqitej një emër i pranueshëm për të gjithë. Vetë Osmani e synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo ajo nuk gëzoi mbështetjen e partive. Për partinë në pushtet ajo nuk i kishte votat e nevojshme, ndërsa për partitë e tjera ajo nuk e ka personifikuar unitetin e nevojshëm që i duhet figurës së presidentit.

PRESIDENTI KURTHI!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Gjykata Kushtetuese biseksuale: GJK e Kosovës përdori “shportën e mbeturinave” edhe për dekreten e Vojsa Osmanit që thuaja e ka përfunduar mandatin sikur edhe për kërkesën e dhunshme të Albulena Haxhiut, kryetare e Kuvendit të Kosovës, me mundësi që të bëhet u. d. e presidentes sikur edhe anëtare e Bordit të “Paqes” të Neronit të Washingtonit, Donald Tramp. Po cila ishte kërkesa e Lenka Kukos për GJK të Kosovës? Ajo, si përfaqësuese e një ndërmarrjeje të dhunshme e quajtur LVV - kishte kërkuar që dhunuesi i pashembullt i Policisë së Kosovës, para ardhjes në pushtet me gurë, mjete të forta, gaz lotsjellës e pasi erdhi në pushtet duke u përzier në punët e Policisë ndonëse ishte dhe është injorant i fushës deri sa njësitë elitare të Policisë i detyroi të jetojnë dhe punojnë në kushte të kanalizimit të hapur e që i la edhe pa veshje dhe ushqim, Xhelal Sfeqla, i njohur si dezertor i luftës, t’i lidhë deputetët e Kuvendit të Kosovës për të siguruar praninë e domosdoshme për zgjedhjen e propozimit “konsensual” të LVV-së për president, Glauk Konjufca - Pinokio i Kurthit. Si laik kushtetues nuk e kam të qartë pse duhet të ketë dy afate kohore për zgjedhje të presidentit/es, 60 ditë dhe 30 ditë? Kjo edhe po shkakton paqartësi te deputetët dhe publiku shkaku se nuk po dihet cili afat është përcaktues. Do të

ishte krejtësisht logjike që këto dy afate të shkrihen në një afat prej 45 ditësh për zgjedhjen e presidentit/es, nga dita e themelimit të Kuvendit të Kosovës. Nëse kjo bëhet normë kushtetuese, do të pushonte nevoja e drejtimit te GJK për interpretim. Nëse mbetet kështu si është, GJK do të mbetet peng e kërcënimit dhe dhunimit nga politikanët dhe ndërkombëtarët sikur që ndodhi kësaj radhe kur injorantët juridik si Qorolli, Sallahu, Rustemi dhe “legjendarja” Lenka Quko ndërhyjnë dhe kërcënojnë GJK sikur Dejona Mihali “aktivistët” e LVV-së! Ndërkombëtarët u treguan më të sofistikuar në presionet ndaj GJK-së, duke mos bërë trysni të dukshme por duke deklaruar se Kosova ka nevojë për “stabilitet institucional...”. Pasi Kurthi i lëshoi brekushet duke përligjur strukturat paralele të Serbisë në Kosovë përmes zbatimit diskriminues dhe antikushtetues të Ligjit për të Huajt, ndërkombëtarët e shohin Kurthin si “garantues të stabilitetit institucional” dhe do ta përkrahin deri sa ta përmbyllë realizimin e Marrëveshjes së Brukselit dhe shtojcës së Ohrit që përfundimisht e federalizon Kosovën në dy entitete politike dhe etnike; serbe në njërën anë dhe kosovare me prejardhje shqiptare në anën tjetër! Po e shohim se si me një hokus - pokus, nga një i urryer dhe i sanksionuar sikur që ishte Kurthi,

falë një “konstruktiviteti” me rastin e legalizimit të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë, shndërroheni në një të dashur dhe të pranuar nga “miqtë ndërkombëtarë ...”. Çfarë shpërftyrimi!

Zgjedhja e presidentit të Kurthit: Lenka Quko, pas vendimit të GJK-së tha se: “do të bëjë çmos që vendi ta ketë presidentin para datës 4 prill në mënyrë që të mos detyrohet të bëhet u.d.e presidentes! Mallëngjyese, aq më parë kur botërisht dihet refuzimin e saj për poste, plotë 56 herë refuzoi të bëhet kryetare e Kuvendit. Sa poshtë kemi rënë! E pabesueshme poshtë, edhe më poshtë se fundi i pusit. Tash Kurthi do t’i thërrasë për “konsultime” Hamzën dhe Abdixhikun, Haradinajn nuk po e konsideron opozitë. Edhe herën e parë veproji njëjtë duke blerë kohë dhe duke shitur mjegull për ta nxjerrë nga kjo tymnajë e mashtrimit Konjufcën dhe Mulhaxhën, që të dy kandidatët të pavarur dhe jopartiakë! Çfarë mashtruesi! Po të kishin dinjitet prej opozitari, as Hamza e as Abdixhiku, për faktin se ishte përjashtuar Ramushin, nuk do duhej ta takonin Kurthin. Tash nuk kanë asnjë arsye të vetme ta takojnë. Kurthi edhe tash blenë kohë, e adreson fajësinë te opozita për bllokim të procesit ndonëse ka pushtet absolut duke e shndërruar qeverisjen në autokraci! Ndërkombëtarët do të

kërkojnë që opozita ta luajë lojën e Kurthit e që këta nuk duhet të pranojnë. Opozita nuk mund të pajtohet për një kandidat konsensual prandaj nuk ka asnjë detyrim ta votojë propozimin e Kurthit. Kurthit nuk i konvenojnë zgjedhjet kurse për opozitën zgjedhjet e parakohshme janë mundësi e artë për t’u faktorizuar dhe bashkuar kundër mentalitetit diktatorial të Kurthit. Kurthi e negocioi tinëzisht dhe pabesisht Ligiin për të Huaj pa u konsultuar fare me opozitën. Çfarë “konsultimi” kërkon pra Kurthi?! Kërkon nënshtrim pa asnjë kusht të opozitës. Prandaj nuk duhet të takohen me Kurthin në asnjë rrethanë. Çdo takim me Kurthin është vendosje vullnetare e kokës në gjetinën parapolitike të LVV-së. Zgjedhjet duhet të jenë e vetmja zgjidhje politike për opozitën. Kurthi ka kapur çdo gjë që kapet duke instaluar udbash dhe antikombëtarë në pozita kryesore. Psikopatët po e udhëheqin Universitetin e Prishtinës. Meritokracinë e ka zëvendësuar me llaskucëri. RTK-në e ka shndërruar në Shtëpi Publike të Pornografisë Informative. GJK-në po e kapë me anëtarë të llaskucëve dhe zagarëve që kanë siguruar prani permanente në disa media. Vjosa Osmani, nëse nuk kontrabandohet me një alkimi edhe për një mandat është jetësisht e interesuar për zgjedhje të parakohshme si të vetmen mundësi për “riintegrim politik”,

në të kundërtën është e mbaruar fare! Interesi jetik i opozitës është të mos takohen me Kurthin, interesi jetik i Kurthit është ta manipulojë dhe përçajë opozitën përmes takimeve mashtruese!

Faton P()isi: Faton Peci është njeri i ligë, i pabesë, pa dinjitet dhe pa koç... politike, amebë dhe servil monumental. Sa ishte “ministër” i subvencioneve, për “gjyksat e Hamdisë” kishte dhënë qindra-mijëra euro. Botërisht kishte deklaruar se: “ju nuk e dini se ku i ka shti gjyksat Hamdi Gjyksi..” Çfarë idioti dhe shpërdoruesi. Me gjysmën e parave të Hamdi gjoksit do t’i siguronte “gjyksat” e Kim Kardashianit apo Monika Belluçit. Tash i ka dalë rend me i largu fotot e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit nga Mitrovica që po e ndanë bashkë me Milan Radoiçiqin, ky në jug, tjetri në veri. Po flitet se në mesin e atyre që i larguan fotot e dy kryeçlirimtarëve të Kosovës, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli ishte edhe ambasadori gjerman në Kosovë, i maskuar si Jack Smith, ish-kryeprokurori kriminal i Gjykatës Speciale. Gjithashtu po flitet se pas largimit të fotografive të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, si dëshmi e përkushtimit të Zbatimit të Ligjit për të Huaj do të vendosen bilbordat e Mimoza Kusarit me Milan Radoiçiqin duke bërë një bisedë të përzemërt telefonike kundër UÇK-së! Faton P (l) isi, antikombëtar!

KPK-ja forcon bashkëpunimin me BE-në në funksion të sundimit të ligjit

PRISHTINË, 26 MARS - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Arian Gashi, së bashku me anëtarin e Këshillit, Milot Krasniqi, kanë pritur në takim Eva Palatovën, ushtruese e detyrës së shefes së Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, e cila shoqërohej nga Annemarie Douwes, nga Fotini Anotnopolou dhe Aferdita Smajli-Kalaja. Gjatë takimit, kryesuesi Gashi i njoftoi përfaqësuesit e Zyrës së Bashkimit Evropian me

prioritetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës, duke theksuar përkushtimin e vazhdueshëm për forcimin e integritetit, pavarësisë dhe efikasitetit të sistemit prokurorial. Në këtë kuadër u diskutua edhe për procesin e konsolidimit të KPK-së si dhe për hapat e mëtejme drejt avancimit të reformave në sistemin e drejtësisë, me theks të veçantë në forcimin e sundimit të ligjit.

Palatova rikonfirmoi mbështetjen e vazhdueshme të Bashkimit Evropian për institucionet e drejtësisë në Kosovë, duke shprehur gatishmërinë për ta thelluar më tej bashkëpunimin me Këshillin Prokurorial të Kosovës. Palët u pajtuan për rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit të ndërsjellë në funksion të forcimit të sundimit të ligjit dhe avancimit të reformave në sistemin prokurorial.



QSU-ja e FSK-së nënshkruan marrëveshje me Universitetin Norwich të ShBA-së

PRISHTINË, 26 MARS - Në Palermo të Italisë, Komandanti i Qendrës për Studime Universitare, major Mimoza Budeci, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me përfaqësuesin e Universitetit Norwich (ShBA).

Universiteti Norwich është ndër institucionet më të vjetra akademik-ushtarake në ShBA, që shkollon dhe trajnon liderët e ardhshëm ushtarakë të Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe jo vetëm. Aktualisht Universiteti Norwich renditet në mesin e tri universiteteve më të mira në ShBA në fushën e teknologjisë

informative, sigurisë kibernetike dhe luftës elektronike.

Bazuar në këto marrëveshje, për herë të parë, duke filluar nga semestri i ardhshëm akademik, kadetë nga QSU do të mund t'i ndjekin studimet e tyre semestrale në Universitetin Norwich dhe në të njëjtën kohë kadetë nga Universiteti Norwich do të kenë mundësi t'i vazhdojnë studimet e tyre ushtarake semestrale në QSU.

QSU-ja po shënon suksese të rëndësishme si institucion akademik ushtarak ndërkombëtar, duke realizuar dhjetëra programe të ndryshme

shkëmbimi të kadetëve me shtete dhe akademi të ndryshme, përfshirë: ShBA-në, Kanadanë, Gjermaninë, Turqinë, Italinë, Kroacinë, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe shtete të tjera.

Sot aktivitetet e Qendrës për Studime Universitare janë bërë pjesë e rregullt e programeve vjetore të akademive ushtarake në ShBA dhe Evropë - një tregues i qartë i profesionalizmit dhe besueshmërisë që QSU po gëzon në arenën ndërkombëtare si Akademi Ushtarak për edukimin e liderëve ushtarakë të së ardhmes.



GRANIT PLAVA NDËRRON DEKLARATËN PËR VRASJEN E LIRIDONA ADEMAJT, THOTË SE KISHTE MARRËVESHJE ME NAIM MURSELIN

PRISHTINË, 26 MARS - I akuzuari për vrasjen e Liridona Ademajt, Granit Plava, e ka ndryshuar deklaratën, duke i thënë Gjykatës Themelore në Prishtinë se vrasja u krye në marrëveshje me bashkëshortin e viktimës, Naim Murseli.

Gjatë gjykimit më 26 mars, Plava u tërhoq nga deklarata e dhënë në polici, duke pohuar se tani po thotë të vërtetën, raporton "Betimi për Drejtësi", media e specializuar në fushën e drejtësisë.

Plava tha se deklaratën në polici e kishte bërë në bazë të marrëveshjes që kishte me Murselin.

Liridona Ademaj u vra në nëntor të vitit 2023. Murseli akuzohet për planifikimin e vrasjes. Në këtë rast akuzohet edhe Kushtrim Kokalla.

Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të tij, avokatit Skender Gojani, i akuzuari Plava tha se kishte marrëveshje me Naim Murselin dhe se ka qenë në dijeni për veprën për të cilën sot po akuzohet. "Asnjëherë nuk më ka treguar



kush është personi [që do ta vriste], edhe më ka thënë veç do ta marrësh përgjegjësinë ti, asgjë tjetër. Pa u bërë dy vjet të nxjerr nga burgu. E di çfarë pushteti kam", tha Plava.

Ai shtoi se për këtë rast ishte në dijeni edhe Behgjet Pacolli, ish-president i Kosovës dhe ish-udhëheqës i Aleancës Kosova e Re. Sipas Plavës, Murseli i ka thënë se "ti e di çfarë pushteti kemi ne" dhe se "nuk ka shanse" që të qëndrojnë në burg "më shumë se dy vjet". Ai

pretendon se Murseli i ka ofruar punë, pagë në vlerë prej 1 300 eurosh, një veturë "G-Class". Kur e ka pyetur se kë do të vriste, sipas Plavës, Murseli i kishte thënë se nuk ka nevojë që ta dijë, por vetëm ta marrë përgjegjësinë.

Kur u pyet nëse i njeh të akuzuarit e tjerë, Plava tha se Kokallën e njeh pasi janë nga fshati i njëjtë e Murselin më pak. Plava tha se me Murselin është takuar 7-8 herë dhe në ditën e vrasjes janë takuar

pikërisht për marrëveshjen. Sipas tij, të nesërmen e kishte kuptuar që personi që e vrau ka qenë gruaja e Naim Murselit. "Më vjen keq për atë ditë çfarë ka ndodhur. Gjithmonë ka thënë se është serbe ose boshnjake, vetëm do ta marrësh përgjegjësinë", tha ai. Më herët gjatë ditës në gjykatore ka folur edhe Murseli. Ai ka insistuar se në natën kur është vlarë bashkëshortja e tij ishte pre e grabitjes, teksa ka pranuar se armën me të cilën është kryer vrasja ia ka blerë Plavës, por duke pretenduar se ai i kishte thënë se të nesërmen do ta shiste dyfish. Murseli pretendoi se me Plavën janë marrë vesh që t'i ktheheshin paratë e armës së blerë.

Si ndodhi vrasja?

Liridona Ademaj u vra në moshën 30-vjeçare më 29 nëntor 2023 në një rrugë në fshatin Bërnice të Prishtinës. Aktakuza e ngarkon Murselin se e ka planifikuar vrasjen e bashkëshortes me qëllim

hakmarrjeje dhe përfitimi financiar nga një sigurim jetësor në Suedi, në shumën prej rreth 260 mijë eurosh. Sipas Prokurorisë, Murseli e ka planifikuar vrasjen në bashkëpunim me Kushtrim Kokallën dhe Granit Plavën, duke u premtuar atyre një shpërblim prej 30 mijë eurosh për ta kryer krimin.

Kokalla akuzohet se e kishte njoftuar Murselin me dorasin Plava.

Plava akuzohet se e ka kryer vrasjen.

Vrasja e Liridona Ademajt shkaktoi zemërim publik, veçanërisht pasi bashkëshorti i saj mori pjesë në varrim.

Familja kërkoi zhvarrosjen e trupit të saj për ta varrosur në varrezat e familjes Ademaj.

Që nga viti 2010 në Kosovë u vranë rreth 60 gra, shumica nga bashkëshortët e tyre.

Organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kritikojnë sistemin e drejtësisë për dënime të lehta të autorëve gjë që, sipas tyre, i trimëron dorasit.

Hamza: PDK-ja do ta respektojë vendimin e Kushtetueses

PRISHTINË, 26 MARS - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka deklaruar se subjekti që ai drejton do ta respektojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, duke theksuar rëndësinë e zbatimit të vendimeve të institucioneve më të larta juridike në vend.

Ai këto komente i bëri para takimit të përbashkët të kryesisë dhe grupit parlamentar të PDK-së. Hamza ka theksuar se në ditët e ardhshme është planifikuar edhe një takim i Këshillit

Drejtues të PDK-së. "Ne jemi shprehur qartë që PDK-ja e respekton vendimin e Kushtetueses, sepse duhet të respektohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Sot kemi mbledhje të Kryesisë dhe Grupit Parlamentar, ndërsa ditëve të ardhshme presim të kemi edhe mbledhje të Këshillit Drejtues. Do të diskutojmë qëndrimet tona, pozicionin tonë dhe mbi bazën e vendimeve të organeve të PDK-së do të dalim zyrtarisht me qëndrimin tonë", ka theksuar Hamza.

Ai shtoi se çdo diskutim lidhur me mundësinë e ndonjë kompromisi duhet të kalojë përmes strukturave vendimmarrëse të partisë, duke theksuar se deklaratimet paraprake nuk janë të përshtatshme. "Gjithçka që flasim para diskutimit në organet e PDK-së nuk është e duhura, për shkak se ato janë forumet ku duhet të diskutohet dhe të merren vendime, e pastaj të qëndrohet në këto vendime", ka deklaruar ai. I pyetur nëse ka marrë ftesë nga



kryeministri Albin Kurti për të biseduar lidhur me kandidatin

për president, Hamza u përgjigj shkurt: "Nuk ka ftesë".

Ministria e Bujqësisë synon kursime prej një milion eurosh në vit nga heqja e qirave

PRISHTINË, 26 MARS - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka njoftuar se ka marrë një vendim për racionalizimin e hapësirave administrative, me qëllim uljen e kostove dhe rritjen e efikasitetit institucional. Sipas njoftimit, ky vendim parasheh zhvendosjen e ministrisë dhe institucioneve vartëse në objekte publike, duke shmangur shpenzimet për qira dhe duke shfrytëzuar më mirë pronën shtetërore. “Sot kam nënshkruar një vendim për

racionalizimin e hapësirave administrative në Ministrinë e Bujqësisë. Ky vendim hap rrugën për zhvendosjen e Ministrisë dhe institucioneve vartëse në objekte publike, duke shfrytëzuar pronën e shtetit dhe duke i dhënë fund kostove të panevojshme të qirasë”, ka njoftuar ministri Armend Muja. Po ashtu, bëhet me dije se do të krijohen edhe Qendra të Integruara për Shërbime Bujqësore të cilat synojnë të ofrojnë shërbime më të shpejta

dhe më të afërta për fermerët. “Po ashtu, po krijojmë Qendra të Integruara për Shërbime Bujqësore, që do të ofrojnë shërbime më të organizuara, më të shpejta dhe më afër fermerit”, thuhet më tej. Sipas ministrisë, masat e ndërmarra pritet të sjellin kursime prej rreth një milion eurosh në vit, të cilat do të ridrejtohen në investime konkrete në sektorin e bujqësisë. “Rezultati: rreth 1 milion euro kursime në vit. Këto kursime do të kthehen menjëherë në investime

konkrete”, thuhet në njoftim, duke përmendur mbështetjen për prodhimin vendor, investimet në mekanizim dhe teknologji bujqësore, zgjerimin e ujitjes si dhe përkrahjen për të rinjtë dhe gratë në bujqësi. Në fund, theksohet se synimi është ndërtimi i një administrate më efikase dhe më të orientuar drejt qytetarëve. “Po ndërtojmë një administratë që kursen aty ku duhet dhe investon aty ku ka më shumë ndikim për qytetarët”, thuhet në njoftim.



THESARI DHE DREJTORIA E BUXHETIT KOORDINOHEN ME KOMUNAT PËR SFIDAT BUXHETORE

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 MARS - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) riafirmoi rolin aktiv në mbrojtjen e interesave të komunave edhe në avancimin e menaxhimit të qëndrueshëm të financave publike, në kuadër të takimit të Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa. Për vazhdimin e punës dhe angazhimit të Kolegjiumit, vetë Kolegjiumi ka zgjedhur kryesues Durim Halilaj, drejtor nga Gjakova, pas zgjedhjeve të fundit lokale, për të siguruar udhëheqje të qëndrueshme dhe koordinim efektiv në trajtimin e sfidave buxhetore të komunave. Në këtë frymë diskutimet u



fokusuan në sfidat aktuale buxhetore me të cilat përballen komunat, veçanërisht në implikimet financiare të zbatimit të kontratës kolektive, e cila po vazhdon të ushtrojë presion të konsiderueshëm mbi buxhetet komunale dhe kërkon koordinim

të shtuar institucional. Në këtë kontekst, drejtori i Thesarit, Nysret Koca, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërinstitucional, konfirmoi gatishmërinë për koordinim të ngushtë me komunat dhe AKK-në. Ai sqaroi se Thesari do t'i

ekzekutojë vendimet e gjykatave në përputhje me detyrimet ligjore, por përmes një procesi konsultativ me komunat për t'i përcaktuar kategoritë që do të preken në buxhetet komunale. Në këtë drejtim ai nënvizoi se është e domosdoshme që ndërhyrjet të përqendrohen kryesisht te projektet që nuk kanë ende obligime kontraktuale, në mënyrë që të mbrohet vazhdimësia dhe integriteti i projekteve ekzistuese. Në të njëjtën linjë, drejtori i Buxhetit, Salvador Elmazi, duke u ndalur fillimisht te rëndësia e planifikimit të qëndrueshëm financiar, theksoi nevojën për një qasje më strategjike në menaxhimin e buxhetit.

Elmazi evidentoi se sfidat aktuale kërkojnë rishikim më të thelluar të planifikimit buxhetor dhe forcim të disiplinës fiskale, duke rekomanduar fokus në përfundimin e projekteve ekzistuese dhe një qasje më selektive në iniciimin e projekteve të reja, të mbështetur në analiza reale financiare dhe koordinim të plotë ndërinstitucional. Takimi riafirmoi se vetëm përmes një bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe të koordinuar ndërmjet AKK-së, komunave dhe institucioneve qendrore mund të adresohen në mënyrë efektive sfidat aktuale dhe të sigurohet stabiliteti fiskal dhe përmirësimi i shërbimeve publike për qytetarët.

GAP-i: KOSOVA MBI MESATAREN NË TRANSPARENCË BUXHETORE, POR ME MANGËSI NË MBIKËQYRJJE

PRISHTINË, 26 MARS - Kosova ka shënuar përparim në transparencën buxhetore, duke u renditur mbi mesataren e rajonit, megjithatë sfidat në publikimin me kohë të dokumenteve dhe në mbikëqyrjen institucionale vazhdojnë të mbeten problematike. Kështu u bë me dije në rezultatet e Anketës së Buxhetit të Hapur 2025 (OBS), të publikuara në një ngjarje rajonale në Tiranë nga Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit (IBP), ku për Kosovën anketimi është realizuar nga Instituti GAP. Sipas raportit, Kosova ka arritur 57 nga 100 pikë

në transparencën buxhetore, duke tejkaluar mesataren rajonale prej 52 pikësh. Megjithatë, në komunikatë theksohet se “një nga mangësitë kryesore mbetet mungesa e publikimit të Rishikimit buxhetor të mesit të vitit”, ndërsa dokumentet për qytetarët nuk publikohen gjithmonë në kohë. Sa i përket pjesëmarrjes publike, Kosova ka marrë 32 pikë, duke u vlerësuar më mirë se vendet e tjera të rajonit, kryesisht falë dëgjimeve buxhetore në nivel komunal. Por, sipas raportit, “niveli qendror nuk organizon dëgjime të tilla me qytetarë apo



aktorë të shoqërisë civile”, ndërsa edhe Kuvendi nuk i përfshin ato në mënyrë të rregullt në procesin e miratimit

të buxhetit. Në aspektin e mbikëqyrjes Kosova ka arritur gjithsej 61 pikë, ku “mbikëqyrja legislative

vlerësohet me 50 pikë, ndërsa mbikëqyrja nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka arritur 84 pikë”, duke reflektuar një nivel më të avancuar të kontrollit të jashtëm të financave publike. Megjithatë, raporti nënvizon se mbikëqyrja nga Kuvendi gjatë zbatimit të buxhetit mbetet e dobët dhe thekson mungesën e një institucioni të pavarur fiskal në vend. Instituti GAP vlerëson se përmirësimi i transparencës, forcimi i mbikëqyrjes dhe koordinimi institucional janë thelbësore për rritjen e besimit të publikut dhe për një qeverisje më efektive në Kosovë.

Abdixhiku për njehsorët elektrikë: Kur shteti dështon, padrejtësia hyn në çdo shtëpi

PRISHTINË, 26 MARS - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka shkruar lidhur me njehsorët elektrikë. Të mërkurën në një konferencë për medie nga kjo parti u paraqitën të gjeturat pas një hulumtimi e ku u tha se këta të fundit matin gabimisht energjinë elektrike. “Ajo që u prezantua dje në

konferencë nga Departamenti ynë për Energji, përmes anëtarit tonë Visar Azemi, është alarmante. Qytetarët po paguajnë më shtrenjtë jo sepse konsumojnë më shumë, por sepse sistemi i matjes po keqllorritet. Nga verifikimi i 884 njehsorëve që aktivistët tanë kanë bërë, 87% rezultojnë të

llogarisin kohën gabimisht, duke faturuar energjinë me tarifë të shtrenjtë edhe gjatë orëve të natës. Kjo nuk është më rastësi. Është dështim sistematik. Prandaj, LDK i fton qytetarët të kontrollojnë njehsorët e tyre. Ne zotohemi se këtë çështje do ta ndjekim në të gjitha nivelet institucionale, deri në vendosjen

e drejtësisë për çdo qytetar”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”. Ai ka theksuar se LDK-ja kërkon hetim të menjëhershëm, përgjegjësi institucionale, kompensim për qytetarët dhe ndaljen e çdo rritjeje të tarifave deri në zbardhjen e plotë të gjendjes reale.



JUL ÇEZARI: PUSHTET, STRATEGJI DHE TRASHËGIMI

Jul Çezari nuk është thjesht një emër në librat e historisë. Ai është një nga figurat më të fuqishme, më të diskutuara dhe më të keqkuptuara që ka njohur ndonjëherë njerëzimi. Për disa, ai ishte një gjeni ushtarak që ndryshoi fatin e Romës. Për të tjerë, një politikan i rrezikshëm që hapi rrugën për fundin e Republikës. Por mes këtyre dy ekstremeve, qëndron një e vërtetë më komplekse, një histori e mbushur me mite, propagandë dhe interpretime që kanë deformuar realitetin. A lindi vërtet me prerje cezariane? A i tha “Edhe ti, Brut?” në momentet e fundit? Dhe mbi të gjitha, kush ishte në të vërtetë Jul Çezari?

Ky artikull ndan mitin nga realiteti dhe zbulon anën e vërtetë të një prej figurave më enigmatike të historisë. Një politikan i fuqishëm, gjeneral ushtrie dhe perandor, Jul Çezari ndihmoi në shndërrimin e Romës në një nga perandoritë më të fuqishme në histori. Ai ishte një udhëheqës i dashur nga shumë njerëz. Por fuqia e tij shkaktoi gjithashtu shumë pakënaqësi tek kolegët e tij politikanë. Ja çfarë duhet të dini rreth jetës së Çezarit, lidhjes që ai pati me Kleopatrën, vrasjen, dhe dramën e famshme të Uilliam Shekspir, që ndihmoi në përjetësimin e figurës së tij:

Miti 1: Jul Çezari lindi me prerje cezariane

Për shekuj me radhë, është besuar se Jul Çezari ishte fëmija i parë i lindur përmes “prerjes cezariane”. Por kjo gjë ka të ngjarë të jetë larg së vërtetës. Burimi i kësaj ngatërrese mund të jetë një enciklopedi historike bizantino-greke e shekullit X-të e quajtur Suda. Ajo pretendonte se prerjet cezariane e kanë marrë emrin e tyre nga vetë Çezari: “Perandorët e romakëve e marrin këtë emër nga Jul Çezari, që nuk kishte lindur në mënyrë natyrale. Nëna e tij vdiq në muajin e nëntë të shtatzanisë. Ndaj njerëzit u detyruan t'i hapin barkun duke e nxjerrë jashtë fëmijën. Dhe në gjuhën romake kjo lloj prerjen quhet “cezariane”. Por kjo nuk ka të ngjarë të ketë ndodhur për disa arsye. Së pari, prerjet cezariane ishin kryer tashmë në Romë në atë kohë. Një ligj që kërkonte kryerjen e prerjeve cezariane në rrethana të caktuara, u miratua gjatë mbretërimit të

Numa Pompilius, që sundoi në vitet 715-673 Para Erës Sonë, pra shumë kohë përpara Jul Çezarit. Sipas ligjit, nëse një grua vdiste gjatë shtatzënisë, ajo duhej t'i nënshtrohej një prerjeje cezariane, pasi ishte kundër besimeve romake varrosja e një nënë me foshnjën e saj në bark. Ligji parashikonte që edhe gratë shtatzëna që ishin duke vdekur t'i nënshtrohen një procedure të tillë, në përpjekje për të shpëtuar jetën e foshnjës. Suda shkruan gabimisht se nëna e Çezarit, Aurelia, vdiq gjatë lindjes. Ndërkohë dihet që jetoi mirë deri në moshë të thyer.

Drama e Shekspir “Jul Çezari” la jashtë një protagonist kyç në vrasjen e perandorit

Drama e Uilliam Shekspir, i zhvillon ngjarjet në vitin 44 Para Erës Sonë. Ajo përshkruan motivet që çuan në vrasjet e tij dhe pasojat e këtij akti. Një nga citatet më të famshme nga drama, e thënë nga Çezari pak para vdekjes së tij është “Et tu, Brute? (Edhe ti Brut?). Në fakt Çezari nuk e tha këtë, pasi ai as që e njohte aq mirë Brutin. Tradhtari i vërtetë është Decimus Junius Brutus Albinus. Por ai përmendet shumë pak në dramë dhe emri i tij ishte shkruar gabimisht. Në fakt, ai ishte miku i Çezarit. Madje, perandori e përfshiu në politikë për ta ndihmuar në rivendosjen në vend të imazhit të familjes së tij. Ata luftuan përkrah njëri-tjetrit në disa betejat. Por në fund, Decimus luajti një rol kyç në atentatin ndaj Çezarit.

Jul Çezari dhe Kleopatra patën një lidhje midis tyre, që solli në jetë një djalë të quajtur Çezarion

Lidhja midis Çezarit dhe Kleopatrës ishte më shumë se sa epsh. Ajo ishte një marrëdhënie, që të dyve u duhej për të arritur synimet e tyre. Që Kleopatra të siguronte pozitat e saj në fronin e Egjiptit, i duhej një ushtri. Më saktë, ajo kishte nevojë për ushtrinë e madhe të Çezarit. Këtij të fundit i interesonte pasuria e madhe për të shlyer borxhet e perandorisë, duke çimentuar pozicionin e tij në pushtet. Kleopatra shkoi të jetonte në Romë me Çezarin. Ata patën së



bashku një djalë, Çezarionin. Shfaqjet publike të dashurisë së Çezarit, frymëzuan edhe ngritjen e një statue të Kleopatrës në Tempullin “Venus Genetrix”. Ajo mbeti më Romë deri në vrasjen e Çezarit, ngjarje që e detyroi të largohej bashkë me djalin.

U vra më 15 marsin e vitit 44 Para Erës Sonë, pasi u godit 23 herë me thikë

Në vitin 44 Para Erës Sonë, Çezari e shpalli veten diktator të përvetshëm. Ndërsa shumë nga ndryshimet dhe reformat e tij u pritën mirë nga popullata e shtresës së ulët dhe të mesme, politikanë u shqetësuan nga fuqia e tij gjithnjë në rritje. Ndaj perandori u godit me thikë për vdekje nga një grup prej rreth 40 senatorësh.

Ju mund të vizitoni vendin ku u vra Jul Çezari

“Largo di Torre Argentina” është sheshi më i vjetër i Romës në ambient të hapur, dhe ishte vendi ku Çezari u godit 23 herë me thikë më 15 marsin e vitit 44 Para Erës Sonë. Ai u shkatërrua gradualisht gjatë shekujve në vijim. Por pas një restaurimi me vlerë 1.1 milionë dollarë, ky sit historik është i hapur për publikun që nga viti i kaluar.

Një bust që mendohet se i përket Jul Çezarit u zbulua në vitin 2007

Disa historianë dhe arkeologë, besojnë se një bust i nxjerrë nga lumi Ron në Francë në vitin 2007, është në fakt i Jul Çezarit. Nëse kjo është e vërtetë, do të ishte e vetmja statujë e mbijetuar e realizuar për perandorin gjatë kohës që ai ishte gjallë. Meqë shumica e paraqitjeve vizuale të Çezarit u bënë pas vdekjes së tij, historianët thonë se ato priren të jenë versione të idealizuara të tij. Por ky bust mendohet se i ngjan liderit ashtu siç dukej realisht, duke treguar një vijë flokësh që tërhiqet pas kohës, dhe rrudha të shumta në ballë. Përmendorja ndodhet aktualisht në Musée Departmental de l'Arles Antique.

U rrëmbye nga piratët, por më vonë u hakmor ndaj tyre

Kur ishte 25 vjeç, Çezari po lundronte me një anije në detin Egje, teksa u rrëmbye nga piratët siçilianë. Ata do të kërkonin 20 talenta argjendi (rreth 600.000 dollarë sot) për lirin e tij. Thuhet se Çezari qeshi në mënyrë ironike dhe u tha se duhej të kërkonin 50 talenta (rreth 1550 kg argjend). Kur bashkëpunëtorët e tij shkuan të merrnin paratë, Çezari u detyrua të priste në robëri. Kur u lirua, ai mblodhi

një grup të vogël ushtarësh, i gjeti piratët, ua preu fytin dhe ua mori argjendin.

Pati 3 gra gjatë jetës së tij

Çezari u martua me Kornelian, gruan e tij të parë, në vitin 84 Para Erës Sonë. Ata patën një vajzë së bashku, por Kornelia vdiq në vitin 69. Dy vite më vonë, Çezari u martua me Pompeian, nga e cila më vonë u divorcua. Më pas u martua me Kalpurnian në vitin 59, dhe jetuan së bashku deri në vdekjen e tij.

Thënie të famshme të Jul Çezarit:

“Erdha, pashë, fitova” ose në latinisht “Veni, Vidi, Vici”. “Njerëzit e besojnë me dëshirë atë që e dëshirojnë”. “Nëse duhet të shkëlmi ligjin, bëjeni këtë për të marrë pushtetin: në të gjitha rastet e tjera respektojeni atë”. “Askush nuk është aq i guximshëm sa të mos shqetësohet nga diçka e papritur”. “Unë e dua tradhtinë, por e urrej tradhtarin!”. Thënie të famshme nga drama “Jul Çezari” e Uilliam Shekspir “Frikacakët vdesin shumë herë para vdekjes së tyre; të guximshmit e përjetojnë vetëm njëherë vdekjen”. “Vdekja, një fund i domosdoshëm, ajo do të vijë kur të jetë koha”. “Kujdes nga Idet e Marsit”. (e thënë nga një fallxhore) / bota.al



SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Osmani viziton Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka vizituar Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë. Osmani në Pejë është mirëpritur nga kryemjeshtri i xhudos, Driton Kuka, së bashku me kampionet olimpike, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi dhe Laura Fazliu, si dhe nga xhudistët e tjerë elitarë të Federatës së Xhudos së Kosovës. Në Qendrën Nacionale të Xhudos gjatë vizitës së presidentes ishin edhe xhudistët nga Ukraina të cilët po qëndrojnë dhe po stërviten në Pejë në Kampin Ndërkombëtar të Xhudos.



KOSOVA U17 MUNDET NGA HOLANDA NË KOHËN SHITESË, MORINA: MËKAT QË LOJËN E MIRË S'E KURORËZUAM ME REZULTAT POZITIV

Kombëtarja U17 e Kosovës ka nisur me humbje rrugëtimin e saj në Ligën B për kualifikime të Kampionatit Evropian U17 i cili zhvillohet në Estoni, por ka treguar paraqitje shumë të mirë përballë gjigantit evropian, Holandës. Në ndeshjen e parë të Grupit B7, e luajtur në Antalya të Turqisë, Kosova është mposhtur me rezultatin e ngushtë 1:0. Goli i vetëm në takim është shënuar nga sulmuesi Donny van der

Lijcke, në minutën e katërt të kohës shtesë. Më herët golin holandezëve ia ka mohuar portieri Erlis Shala, në minutën e 28, kur ka pritur penalltinë. Pas ndeshjes, trajneri i Kosovës U17, Arbnor Morina, ka vlerësuar paraqitjen e lojtarëve dardanë. “Është mëkat i madh që djemtë tanë nuk e kurorëzuan këtë lojë jo vetëm me barazim, por edhe me fitore. Ata treguan lojë shumë të mirë, teksa rastet kanë qenë të barabarta në të



dyja anët. Fatkeqësisht, fundit të kohës shtesë, kur ra ndeshja u vendos në minutat e koncentrimi i ekipit. Mirëpo

duhet t'i përgëzoj djemtë për disiplinën tekniko-taktike dhe për fytyrën e vërtetë që treguan në fushë. Këta lojtarë, së bashku me disa të tjerë jashtë listës së këtij grumbullimi, duhet të llogariten seriozisht për të ardhmen”, ka thënë Morina. Dueli i radhës për Kosovën U17 është më 28 mars kundër Bjellorusisë. Ekipi synon të marrë rezultat pozitiv. Vetëm fituesi i Grupit B7 avancojnë në Ligën A.

BESA FAMGAS KALON NË GJYSMËFINALE PAS FITORES DRAMATIKE NDAJ LLAPIT



PODUJEVË, 26 MARS - Besa Famgas ka kaluar në gjysmëfinalen e Kupës së Kosovës në Hendboll, pas fitores dramatike ndaj Llapit, ndeshje e luajtur në Podujevë.

Në një sfidë interesante ishte skuadra nga Peja që ka siguruar kualifikimin, duke triumfuar me rezultat të ngushtë 29:27 dhe duke prerë biletën për në gjysmëfinale. Në

fazën tjetër të garës janë kualifikuar edhe Kastrioti dhe Rahoveci. Kastrioti ka dominuar ndaj Trepçës me shifrat 41:25, ndërsa Rahoveci ka mposhtur Vëllaznimin me

të njëjtin rezultat bindës. Me këtë rast, gara për trofeun e Kupës së Kosovës në hendboll ka hyrë në fazën vendimtare, me skuadrat që synojnë finalen.

RONALDO JR DREJT REAL MADRIDIT? DJALI I CR7 SHIHET NË STËRVITJE ME GJIGANTËT SPANJOLLË

MADRID, 26 MARS - Cristiano Ronaldo Jr. raportohet se po përgatitet për lëvizjen e parë të madhe në karrierën e tij futbollistike, pasi është parë duke u stërvitur me një nga klubet elitare evropiane. Gjatë historisë së futbollit kanë ekzistuar shumë dyshe të famshme baba-bir, si Cesare dhe Paolo Maldini, Peter dhe Kasper Schmeichel, si dhe Alfie dhe Erling Haaland. Prandaj, sa herë që një futbollist i madh tregon se djali i tij po

përpiqet t'i ndjekë hapat e tij, vëmendja e tifozëve është e madhe. Natyrisht kjo vlen ndoshta më shumë për Cristiano Ronaldon se për çdo lojtar tjetër në historinë e sportit, veçanërisht pas disa raportimeve që sugjerojnë se Ronaldo Jr. është një talent premtues. Tani duket se 15-vjeçari mund të jetë pranë nënshkrimit me klubin e tij të parë evropian, dhe ky do të ishte një hap i madh. Sipas një raporti nga “The Athletic”, Ronaldo Jr,



djali i madh i Cristiano Ronaldos është stërvitur me akademinë e Real Madridit të martën, duke luajtur me ekipin U16, në prag të një transferimi të mundshëm. Aktualisht ai luan si sulmues dhe është pjesë e akademisë së klubit

arab Al Nassr, skuadër me të cilën është i kontraktuar edhe babai i tij deri vitin e ardhshëm. Para se t'i bashkohej Al Nassrit, Ronaldo Jr. ka qenë pjesë e akademive të Manchester Unitedit dhe Juventusit, duke ndjekur kështu rrugën e karrierës së babait të tij. Megjithatë, rikthimi i një “Ronaldo” në radhët e Real Madridit, ku Cristiano Ronaldo është golashënuesi më i mirë në histori të klubit me 450 gola në 438 paraqitje, do të ishte pa

dyshim shumë emocionues për tifozët. Sipas gazetës spanjolle “AS”, për momentin Ronaldo Jr. ka marrë pjesë vetëm në dy seanca stërvitore me akademinë e Real Madridit, me më shumë të tilla që priten në të ardhmen, pasi ai ka lënë një përshtypje “perfekte” në provën e parë. Megjithatë, Real Madridi nuk është klubi i vetëm që po e ndjek talentin e ri, pasi disa klube të tjera të mëdha evropiane po e monitorojnë përparimin e tij.

Beteja Senegal - Marok zhvendoset në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv

DAKAR, 26 MARS - Senegali ka paraqitur ankesë në Gjykata e Arbitrazhit për Sport (CAS) pas vendimit për t'ia hequr fitoren në Kupën e Afrikës ndaj Maroku. Vendimi i Konfederatës Afrikane të Futbollit ka anuluar triumfin 1-0 të Senegalit dhe e ka

regjistruar atë si humbje 3-0, duke ia dhënë titullin Marokut. Ky vendim ka ardhur pasi është vlerësuar se lojtarët senegalezë kishin braktisur përkohësisht fushën në shenjë proteste ndaj një penalltie të diskutueshme në minutat shtesë. Federata e Futbollit e

Senegalit ka kërkuar që vendimi të anulohet dhe ata të shpallen fitues zyrtarë. CAS-i ka konfirmuar se procedura tashmë ka nisur, por ka paralajmëruar se procesi mund të zgjasë për shkak të kompleksitetit të rastit. Një panel arbitrazhi do ta

shqyrtojë çështjen, ndërsa afatet për vendimin final mbeten të paqarta. Drejtori i përgjithshëm i CAS-it, Matthieu Reeb, ka theksuar se institucioni do të punojë për një zgjidhje sa më të shpejtë, duke garantuar proces të drejtë për të gjitha palët.



NJOFTIM

Njoftojmë se kompania "CML BUSINESS LLC" nga Fushë Kosova, me numër unik identifikues 812253772 ka marrë vendim për mbyllje të biznesit.

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët afarist që kanë raporte Debitore-Kreditore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë

NOTIFICATION

We inform all customers that the company "CML BUSINESS LLC" with address in Fushe Kosova, has decided to close the business with unique identification number 812253772, and has appointed the liquidator for the development of the liquidation procedure. All clients who have Credit-Debt reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavam svu klijentelu da je kompanija "CML BUSINESS LLC", sa adresom Fushe Kosova, odlučila da pestaje radni aktivnost sa jedinstvenim identifikacionim brojem 812253772, i imenovao likvidatora za razvoj postupka likvidacije. Svi klijenti koji imaju kreditno-debitne izveštaje u ovoj kompaniji su obavešteni da se pojave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Air Kosmaç” SH.P.K. pronar Fehmi Podrimqaku dhe Niman Babaj me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812384022 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTEN.JE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Air Kosmač” D.O.O. Fehmi Podrimqaku dhe Niman Babaj Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812384022 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Air Kosmaç” L.L.C. with owner Fehmi Podrimqaku dhe Niman Babaj with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812384022 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nadir Berisha shpall të pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Fatmir Gashi shpall të pavlefshme diplomën shme “Ymer Prizreni” Prizren.
- Mikel Oroshi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Qendrim Ahmetaj shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Reis Miftari shpall të pavlefshme diplomën shme “Ymer Prizreni” Prizren.
- Berat Mazrek shpall të pavlefshme diplomën e shkollës fillore “Ana Dollu” Mamush.
- “Joes Caffè” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810174847 Fushë Kosovë.
- Alban Sahatçiu B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr:3300354423.
- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës “Trim” SH.P.K. gjatë orarit të punës.
- Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.
- Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh. profesionale “Dituria” Prizren.
- Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.
- Zejnie Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

